



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:262640
Datë: 22.03.2024
Numri i dokumentit: 05491055

C.nr.4593/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Taulant Rexhëbeqaj, në çështjen juridike kontestimore të paditëses R.R. me numër personal 1..... nga fshati komuna e Prizrenit, të cilën me autorizim e përfaqëson av. A.H. nga Prishtina, kundër të paditurit Komuna e Mamushës-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontestit kompensimin e inflacionit, jashtë seance, më datën 22.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET se padia me numër C.nr.4593/2023 e paditëses R.R. kundër të paditurës Komuna e Mamushës-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontestit kompensimin e inflacionit është **tërhequr**.

A r s y e t i m

Paditësja R.R. nga fshati Piranë, komuna e Prizrenit, përmes të autorizuarit të saj av. A.H. pranë kësaj gjykate me datën 30.11.2023, ka parashtruar padi, ndaj të paditurës Komuna e Mamushës-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontestit kompensimin e inflacionit

I autorizuari i paditësit me parashtrësën, e datës 20.03.2024 ka njoftuar gjykatën se tërheq padinë. Me qene se pranë kësaj gjykate është duke u zhvilluar procedure kontestimore me baze te njëjte dhe lënda është ende aktive është paraqitur më herët për të cilën e kanë zgjeruar padinë për te ekonomizuar procedurën.

Si rrjedhojë, bazuar në nenin 261.1 të LPK-së, gjykata vlerëson se janë plotësuar kushtet ligjore për të konstatuar se paditësja e ka tërhequr padinë.

Nga të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr. 4593/2023, të datës 22.03.2023

Gjyqtari

Taulant Rexhëbeqaj

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa, bazuar në nenin 261.4 të LPK-së.